



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **02.03.2021** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi anëtari me i vjetër i Komitetit për Komunitete z. **Ramë Berisha**.

Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete. Për këtë mbledhje propozoj:

R E N D I T E

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete;

2. Të ndryshme.

Skender Hamza - Përshëndetje për te gjithë te pranishmit. Për këtë mbledhje do te asistoj Ramë Berishe rreth procedurës dhe njeherit ju uroj te gjithë anëtareve për mandatin e ri. Ky komitet është formuar me 25.01.2022 nga ana e kuvendit te komunës me këtë përbërje që jeni prej shtatë anëtareve. Sipas udhëzimit administrativ 05/2020 për procedurën e themelimit përbërjen dhe kompetencën te komiteteve te përhershme dhe komiteteve tjera ne komunë, ku ne nenin 8-të tek përbërja e komitetit thuhet, se komiteti për Komunitete përbehet nga anëtarët e kuvendit te komunës dhe përfaqësuesit e komuniteteve. Komiteti për komunitete përbehet nga se paku një përfaqësues i komuniteteve jo shumicë që jeton ne komunë. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë ne komunë e përbejnë shumicën e anëtareve te komitetit për komunitete i cili komitet duhet te reflektoj barazinë gjinore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Sa i përket kësaj, ne jemi gjithçka ne rregull proceduralisht pasi MAPL-ja na ka kthye konfirmimin e ligjshmërisë sa i përket këtij komiteti. Kështu ashtu siç e tha edhe kryesuesi i mbledhjes z.Ramë Berisha pikë e renit te ditës do te jetë zgjedhja e kryesuesit dhe kisha kërkuar se pari prej anëtareve te komitetit për komunitete që te bëni propozimet për anëtarin për kryesues.

Shqipe Kryeziu –Unë propozoj Bajram Morinën.

Bajram Morina – Unë propozoj Dusan Stojanovic

Skender Hamza – Fillimisht e kishum formue komisionin prej 3 anëtareve që te bëj verifikimin e procesit te votimit dhe numërimin e tyre. Kështu që ju anëtar te komitetit duhet propozoni emrat e komisionit prej 3 anëtareve për zgjedhjen kryesuesit.

Faton Ramandani – Unë propozoj Edona Kryeziu si anëtare e komisionit për zgjedhjen e kryesuesit.

Shqipe Kryeziu – Unë propozoj Edonita Berisha

Edona Kryeziu – Unë propozoj Shqipe Kryeziu

Skender Hamza – Tani komisioni mund te bej verifikimin e kutisë se votimit dhe me procedurën e zgjedhjes se kryesuesit.

Tani me përfundimin e e votimit ,e lus komisionin që te bëj verifikimin dhe numërimin e votave.

Shqipe Kryeziu – Komisioni ka konstatuar se kemi 7 fletëvotime te vlefshme, ku 6 vota janë për Bajram Morina dhe 1 votë është për Dusan Stojanovic.

Skender Hamza – Faleminderit komisionit, urime kryesuesit për mandatin e ri.

Bajram Morina – **Kryesues i Komitetit për Komunitete** – Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, anëtarët e komitetit për komunitete, përfaqësues te OSBE-së dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Ju

faleminderit për mbështetjen në përzgjedhjen time edhe për një mandat si kryesues i komitetit për komunitete, kështu që ju uroj suksese dhe punë të mbarë.

Skender Hamza – Faleminderit kryesues, tani ne duhet të zgjedhim edhe zëvendës kryesuesin e komitetit për komunitete, mirëpo në këtë rast zgjedhjen do ta bëjmë me vota të hapura dhe që duhet të jetë nga komuniteti serb dhe në këtë rast si i propozuar është Dusan Stojanovic.

Bajram Morina – Atëherë e qesim në votim zëvendës kryesuesin e komitetit për komunitete. Konstatohet se me 7 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë apstenim, emërohet z. Dusan Stojanovic si zëvendës kryesues i komitetit për komunitete.

2. Të ndryshme.

A ka dikush diçka sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës.

Rame Berisha – Përshëndetje për të gjithë dhe uroj për mandatin e ri, kjo është mbledhja e parë për këtë vit që u bë edhe zgjedhja e kryesuesit, kështu që ju dëshiroj suksese dhe punë të mbarë rreth pikave që do të caktohen për mbledhje të komitetit për komunitete për të mirën e përgjithshme pa dallim.

Bajram Morina – Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatohet se takimi i parë i komitetit për komunitete është deklaruar të mbyllur dhe shihmi në mbledhjen e radhës.


Pracësmbajtësi
Agim Hoti


Kryesuesi i Mbledhjes
Bajram Morina